



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 shtator 2023
Nr. ref.: RK2247/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI207/21

Parashtrues

Bajram Koliç

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit Rev. nr. 231/2021 të 9 qershorit 2021 të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Bajram Koliç nga Banja e Pejës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 231/2021] të 9 qershorit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktvendimin [Ac. nr. 1663/2017] e 25 gushtit 2020 të Gjykatës së Apelit, dhe Aktgjykimin [C. nr. 2946/2013] e 20 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 28 korrik 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] dhe 7 [Nuk ka Dënim pa Ligj] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës, nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës, nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 19 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 22 nëntor 2021, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI207/21, caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese, dhe me Vendimin nr. KSH. KI207/21, Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
9. Më 23 nëntor 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

10. Më 2 dhjetor 2021, Gjykata për regjistrimin e kërkesës e njoftoi Gjykatën Themelore dhe kërkoi nga ajo që të sjellë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
11. Më 9 dhjetor 2021, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
12. Më 1 shkurt 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë.
13. Më 8 korrik 2022, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë dosjen e plotë të lëndës.
14. Më 20 korrik 2022, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dosjen e lëndës.
15. Më 6 shtator 2022, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe Policisë së Kosovës, ku nga kjo e fundit kërkoi që të dorëzoi kopjen e Udhëzimit Administrativ UA 06/2012 për Shkelje, Masat dhe Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës.
16. Më 9 shtator 2022, Policia e Kosovës dorëzoi në Gjykatë Udhëzimin Administrativ UA 06/2012 për Shkelje, Masat dhe Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës.
17. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
18. Më 7 shkurt 2023, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë që ndërlidhen me rastin e tij. Në ato dokumente ka bashkëngjitur dy raste të Gjykatës së Apelit, ku thekson se në këto raste Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka parashtruar revizion në Gjykatën Supreme, ndërsa në rastin e tij ka parashtruar revizion.
19. Më 27 korrik 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

20. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës kishte qenë në marrëdhënie pune në Policinë e Kosovës në vendin e punës Zëvendësdrejtor Rajonal për hetime në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Pejë (në tekstin e mëtejshëm: DRP).

Procedura administrative

21. Më 31 maj 2012, Komisioni përkatës, në kuadër të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, me urdhër të Gjykatës, kishte shkuar në Stacionin e Policisë në Pejë, me qëllim që të merr në administrim një sasi të arit dhe të hollave të cilat ishin konfiskuar në vitin 2008 nga Njësia e Krimeve Ekonomike e Policisë së Kosovës të Regjionit të Pejës. Të gjitha këto kishin qenë të sistemuara në dhomën e dëshmive, ku komisioni në prezencë të zyrtarit përgjegjës të dhomës së dëshmive, kishte filluar me numërimin e të hollave, shuma këto të cilat ishin përputhur me shumën që ishte dorëzuar me rastin e pranim-dorëzimit të të njëjtave në dhomën e dëshmive në vitin 2008, por kur kishte filluar matja e sasisë së arit, ishte vërejtur se sasia e arit që ndodhej në dhomën e dëshmive nuk përputhet me sasinë e arit të dorëzuar në vitin 2008.

22. Në të njëjtën datë, Inspektorati Policor i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: IPK), si rezultat i njoftimit për mungesën e kësaj sasi të arit në dhomën e dëshmimeve në Stacionin Policor në Pejë, dërgoi hetuesit në vendngjarje.
23. Për qëllime të hetimit të këtij rasti ishte formuar një komision i përzier për revizionin e dhomës së dëshmimeve të Stacionit Policor në Pejë, dhe atë: dy inspektorë nga IPK, dy hetues të Drejtoratit të Krimeve të Rënda të Policisë, dy krimteknik nga Njësia e Forenzikës të Drejtoratit të Krimeve të Rënda dhe dy krimteknik nga Forenzika Regjionale e Policisë në Pejë. Nga hetimi i bërë, Komisioni kishte hartuar një raport ku kishte cekur gjetjet nga të cilat kishte rezultuar se *“gjendja e dëshmimeve në dhomë ishte shumë e keqe, pasi që brenda saj ekzistonte një sasi e madhe të dëshmimeve të ndryshme që janë grumbulluar që nga viti 2000. Brenda dhomës së dëshmimeve, ishte një sistemim i çrregullt i tyre, paketime dhe dëshmi të ndryshme të gjërave, pa ndonjë sistemim adekuat, pastaj qeset e paketimeve, që përdoren për mbajtjen dhe ruajtjen e dëshmimeve, një numër i konsiderueshëm i tyre ju mungonin përshkrimet e nevojshme lidhur me rastin dhe dëshminë. Komisioni, kishte vërejtur se, vendosja dhe ruajtja e dëshmimeve brenda dhomës së dëshmimeve, nuk ka pasur ndonjë klasifikim në nivel sigurie. Dëshmitë me vlerë si ari, paratë e sende të tjera me vlerë janë trajtuar njëjtë si të gjitha llojet e tjera të dëshmimeve. Po ashtu nuk ka informacion se ku kanë përfunduar 222 armë dhe 45 raste me dëshmi tjera d.m.th. nuk dihet destinacioni i fundit i tyre”*.
24. Më 1 qershor 2012, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Drejtori i Policisë) me Vendimin [DPPK-01/604/2012] parashtruesin e kërkesës e suspendoi nga puna me pagesë, dhe ia ndaloi hyrjen në ndërtesa, zyre apo vetura të Policisë së Kosovës, pa leje speciale.
25. Më 15 tetor 2012, Prokuroria Speciale nëpërmjet Vendimit [PPS. nr. 57/2012], pushoi hetimet ndaj parashtruesit të kërkesës, pasi që nuk kishte gjetur asnjë provë që parashtruesi i kërkesës kishte kryer veprën penale të krimit të organizuar nga neni 274, paragrafi 3 i Kodit nr. R. 2003/25 të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK) lidhur me veprën penale “përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare” nga neni 340, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe lidhur me nenin 23 të KPK-së, për të cilën dyshohej.
26. Më 21 tetor 2012, bazuar në shkresat e lëndës, Ministria e Brendshme kishte nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 06/2012, për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore në Policinë e Kosovës, i cili udhëzim ishte ndryshuar më 14 tetor 2013.
27. Më 3 dhjetor 2012, IPK kishte hapur rastin [MPB/IPK/08/2012] për shkelje të rëndë disiplinore (shkelje e rëndë e autorizimit) kundër parashtruesit të kërkesës i cili deri më 1 korrik 2012 kishte ushtruar detyrën e Zëvendës Drejtorit për hetime në Regjionin e Pejës, për shkak të dështimit në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të caktuara të cilat kanë shkaktuar efekte negative në reputacionin e policisë. IPK duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, nenin 34, paragrafi 3.2, në Doracakun e Parimeve dhe Procedurave, parimin 3.27 pika 2, në Udhëzimin Administrativ nr. 06/2012 për “Shkeljet, Masat dhe Procedurën Standarde të Operimit për dhomën e dëshmimeve” kishte vërejtur se parashtruesi i kërkesës kishte kryer shkelje të rëndë disiplinore, sjellje të rëndë diskredituese dhe shkelje të rëndë të autorizimit dhe i kishte rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që të ndërmerren masa disiplinore “Degradim” dhe “Transfer administrativ”.
28. Më 27 dhjetor 2012, Drejtori i Policisë nëpërmjet Vendimit [DPPK-01/1518/2012], parashtruesit të kërkesës ia shqiptoi masën disiplinore degradim nga grada major në gradën kapiten së bashku me masën e transferit administrativ, me arsyetimin se ka

kryer veprën që është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ nr. 06/2012, për shkeljet, masat dhe procedurat disiplinore, nga neni 18 pika a) “*pa ndonjë arsye bindëse nuk i përmbushë apo dështon t’i përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara të cilat kanë shkaktuar apo mund të shkaktojnë efekte negative në reputacionin e Policisë së Kosovës dhe në efikasitetin e kryerjes së detyrave*”, për shkak se gjatë ushtrimit të detyrës së Zëvendësdrejtorit për hetime në Policinë e Kosovës për Rajonin e Pejës ka dështuar në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të caktuara të cilat kanë shkaktuar efekte negative në reputacionin e Policisë.

29. Më 3 janar 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë drejtuar Ministrit të Punëve të Brendshme, kundër Vendimit [DPPK-01/1518/2012] të 27 dhjetorit 2012 të Drejtorit të Policisë, për shkak të shkeljes themelore të Udhëzimit Administrativ 06/2012 për shkeljet, masat dhe procedurat disiplinore në Policinë e Kosovës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që të anulohen masat e marra ndaj tij dhe të lirohet nga akuza.
30. Më 25 janar 2013, Ministri i Punëve të Brendshme nëpërmjet Vendimit [nr. 43], hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi vendimin e Drejtorit të Policisë.

Procedura gjyqësore

31. Më 15 shkurt 2013, parashtruesi i kërkesës, në kuadër të procedurës kontestimore, paraqiti padi në Gjykatën Themelore kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme-Policisë së Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (në tekstin e mëtejme: Ministria e Punëve të Brendshme), përkatësisht Vendimit nr. 43 të Ministrit të Punëve të Brendshme, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljen e rregullave të procedurës, ku kërkoi anulimin e vendimit të Ministrit dhe anulimin e vendimit të Drejtorit të Policisë për degradim nga grada major në gradën kapiten dhe masën plotësuese transfer administrativ.
32. Më 20 dhjetor 2016, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktgjykimit [C. nr. 2946/2013]: (i) aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) anuloi Vendimin [DPPK-01/1518/2012] e 27 dhjetorit 2012 të Drejtorit të Policisë dhe Vendimin [nr. 43] e Ministrit të Punëve të Brendshme; (iii) anuloi si të kundërligjshëm vendimin për degradimin e parashtruesit të kërkesës nga grada major në gradën kapiten së bashku me masën e transferit administrativ; (iv) detyroi të paditurën që parashtruesit të kërkesës t’i kthej gradën major dhe të përcaktoj në detyrat e vendit të punës Zëvendësdrejtor Regjional për hetime në Policinë e Rajonit të Pejës; (v) detyroi të paditurën që parashtruesit t’ia kompensojë ndryshimin e pagave të papaguara për periudhën kontestuese prej 8 gushtit 2012 gjer më 30 qershor 2016 edhe atë me kamatë prej 8% si dhe trustin për sigurim pensional dhe tatimin për Administratën Tatimore, si dhe shpenzimet e procedurës së përgjithshme, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin të përmbarrimit me dhunë.
33. Në një datë të pasaktësuar, Ministria e Punëve të Brendshme, e përfaqësuar nga avokatura shtetërore, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimin e goditur me ankesë ta ndryshoj, duke refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ose të njëjtin ta kthej në rigjykim.

34. Më 25 gusht 2020, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktgjykimit [Ac. nr. 1663/2017]: (i) refuzoi pjesërisht si të pabazuar ankesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 2946/13] e 20 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore, në lidhje me pikat II dhe III të dispozitivit, pika IV pjesa e dispozitivit (kthimit të gradës së majorit) dhe pika V pjesa e dispozitivit (detyrimi i të paditurit që paditësit t'ia kompensojë ndryshimin e pagave të papaguara për periudhën kontestuese prej 8 gushtit 2012 gjerë më 30 qershor 2016, trustin për sigurim pensional, tatimin dhe kamatën) në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë; (ii) aprovoi pjesërisht si të bazuar ankesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme; prishi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 2946/13] të 20 dhjetorit 2016, në pikën IV të dispozitivit, pjesa e kërkesëpadisë që ka të bëjë vetëm me kthimin në punë si Zëvendës drejtor Regjional për hetime në Policinë e Regjionit të Pejës, dhe pikën V e dispozitivit të aktgjykimit në pjesën që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës dhe lënda për këtë pjesë i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.
35. Në një datë të pasaktësuar, Ministria e Punëve të Brendshme e përfaqësuar nga avokatura shtetërore, paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohen të dy aktgjykimet e lartpërmendura ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.
36. Më 9 qershor 2021, Gjykata Supreme nëpërmjet Aktgjykimit [Rev. nr. 231/2021]: (i) aprovoi si të bazuar revizionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ndryshoi Aktgjykimin [Ac. nr. 1663/2017] e 25 gushtit 2020 të Gjykatës së Apelit, në pjesën I të dispozitivit, dhe Aktgjykimin [C. nr. 2946/2013] e 20 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore, ashtu që refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës e bërë kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme; (ii) Aktgjykimi [Ac. nr. 1663/2017] i 25 gushtit 2020 i Gjykatës së Apelit, në pjesën II të dispozitivit mbetet i pashqyrtuar, pasi që për këtë pjesë nuk ishte drejtuar revizioni, pasi që lidhur me këtë pjesë lënda ishte kthyer në rigjykim në shkallën e parë nga ana e Gjykatës së Apelit.
37. Gjykata Supreme arsyetoi se gjykatat e instancave më të ulëta kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale, dhe rrjedhimisht arriti në përfundimin se nuk mund të pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, "*... pasi që aktgjykimet e këtyre gjykatave në këtë çështje kontestimore përfshihen me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilën arsye të njëjtat është dashur që të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësit ndaj të paditurës, të refuzohet në tërësi si e pabazuar ...*".
38. Më konkretisht, Gjykata Supreme fillimisht vlerësoi se "*gjykata nuk ka të drejtë të vlerësojë se punëtori këtu parashtruesi i kërkesës a ka bërë apo jo shkelje disiplinore, respektivisht, se sjelljet dhe veprimet e tij apo mosveprimet a paraqesin shkelje disiplinore të parapara me akte të brendshme, ngase këtë mund ta bëjë vetëm punëdhënësi duke respektuar në përpikëri dispozitat e procedurës disiplinore dhe dispozitat tjera përcjellëse, ndërsa gjykata ka të drejtë dhe autorizim që të vlerësojë në përgjithësi ligjshmërinë e procedurës që i ka parapri nxjerrjes së vendimeve të kontestuara, dhe ligjshmërinë e vet këtyre vendimeve*".
39. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme, duke vlerësuar ndryshe provat, konstatoi se: "*[...] Konstatimet e gjykatës së shkallës së parë se paditësi me përpikëri ka kryer detyrat e veta dhe se nuk ka qenë mbikëqyrës dhe përgjegjës i dhomës së dëshmive, janë të pa qëndrueshme, ngase sipas vendimit kontestues të paditurës për uljen e gradës dhe transferin administrativ të paditësit rezulton se Inspektorati Hetimor i Policisë (IPK) gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj paditësit major Bajram Koliçi, ka*

vërtetuar se paditësi me mosveprim nuk ka kryer detyrat e veta me përgjegjësi, ashtu që paditësi gjatë kohës që ka qenë zëvendës drejtor për hetime në Rajonin e Pejës, duke e ditur se sasia e arit të konfiskuar ka qenë shumë e madhe, kurrë nuk është interesuar që të di se sa është vlera e kësaj sasive të arit. Nuk ka shprehur asnjëherë interesim për krijimin e kushteve për sigurinë me të mirë të kësaj sasive të arit, si dhe dëshmitë të tjera të cilat ndodhen në dhomën e dëshmitë. Sipas IPK, paditësi dhe kolonel A.H si Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë, dhe toger R.R., duke qenë shef i Forenzikës dhe mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i zyrtares përgjegjëse R.L., kanë dëshmuar se shumë herë kanë qenë anëtarë të Komisionit për inspektimin e dhomës së dëshmitë por, kurrë nuk janë interesuar se ku dhe në çfarë kushtesh të sigurisë është duke u ruajtur ari i konfiskuar, dhe se ata kurrë nuk janë interesuar që gjendja e dhomës së dëshmitë të rregullohet dhe dëshmitë të trajtohen sipas ligjeve dhe rregullave, ku si pasojë e këtij mosveprimi të tyre ka ardhur gjerë te marrja e arit në sasi prej 25,3 kg, nga dhoma e dëshmitë gjatë periudhës kohore prej vitit 2008 deri në vitin 2012. ... Nuk qëndron as konstatimi i gjykatave të instancës më të ulët se Ligji i punës dhe Ligji i Policisë së Kosovës, nuk e parashohin të drejtën e marrjes së gradës, sepse degradimi në pozitë pune nga marrja e gradës janë dy institucione të ndara juridike. Këto konstatime janë të paqëndrueshme ngase në nenin 48 të Ligjit për Policinë nr. 03/L-035, parashihet që zyrtari policor ose stafi civil i policisë i cili ka kryer shkelje të rëndë disiplinore i nënshtrohet disa masave disiplinore ndër të tjera edhe uljes së gradës sipas pikës b) të këtij neni”.

40. Më 13 shtator 2021, gjatë seancës shqyrtuese, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Gjykatës Themelore me kërkesë për tërheqje të padisë sa i përket kthimit në vendin e punës Zëvendëskomandant për hetime në Regjionin e Pejës. Të njëjtën ditë, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit [C. nr. 3995/2020] konstatoi të tërhequr padinë e parashtruesit të kërkesës, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, sa i përket kthimit në vendin e punës Zëvendëskomandant për hetime në Regjionin e Pejës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

41. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] dhe 7 [Nuk ka Dënim pa Ligj] të KEDNJ-së.

i. Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës

42. Duke iu referuar pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se me caktimin e masës disiplinore të uljes së gradës nga grada Major në gradën Kapiten dhe masën e transferit administrativ ishin zbatuar gabimisht dispozitat e nenit 18, pikës (a) dhe nenit 45, paragrafi 1 pika 1.2 dhe paragrafi 2 pika 2.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2012, sepse sipas parashtruesit të kërkesës *“ky udhëzim administrativ ka hyrë në fuqi më 21 tetor 2012, ndërsa masa e pretenduar disiplinore për të cilën akuzohem është kryer në një periudhë më të gjatë, përfundimisht deri më 1 qershor 2012 kur ky udhëzim ende nuk ishte nxjerrë”*.
43. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i bazuar në legjislacion që nuk ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar disiplinore, për të cilën ai është shpallur fajtor. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se është zbatuar dispozita e nenit 48 të Ligjit nr. 03/L035 për

Policinë, i cili Ligj sipas tij nuk ka mundur të zbatohet në zgjidhjen e kësaj çështje, sepse sipas tij ky ligj ishte shfuqizuar me miratimin e Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë, dhe se me hyrjen në fuqi të ligjit të ri është shfuqizuar ligji i vjetër, dhe se Gjykata nuk ka mundur të aplikojë nenin 48 të ligjit të vjetër.

44. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme mbajti qëndrim krejtësisht të gabuar sepse *“pa një gjendje faktike të vërtetuar mirë dhe plotësisht nuk ka zbatim të drejtë të ligjit dhe pa zbatim të duhur të ligjit nuk ka as gjykim të drejtë dhe kjo është arsyeja pse më jep të drejtën që unë të kërkoj nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës mbrojtjen e të drejtës për gjykim të drejtë siç parashihet me nenin 31, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së”*.
45. Sipas parashtruesit të kërkesës, *“... qëndrimi i Gjykatës Supreme, se gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk kanë të drejtë të merren me gjendjen faktike, por duhet ta pranojnë si të drejtë dhe të vërtetë gjendjen faktike ashtu si është vërtetuar nga ana e organit administrativ, pa kurrfarë vlerësimi dhe kontrolli, vjen në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe kësaj përbën shkelje të nenit 6, pika 1 të KEDNJ-së”*. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është në kundërshtim me qëndrimet e GJEDNJ-së, dhe në këtë kuptim duke iu referuar vendimeve të GJEDNJ-së: *Sikic kundër Kroacisë nr. 9143/08 pika 48, dhe Y kundër Norvegjisë nr. 56568/00, thekson se në rrethanat e rastit të tij zbatohet neni 6, paragrafi 2 i KEDNJ-së*.
46. Parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur edhe dispozitat e Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, i cili nuk e lejon revizionin si mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, sepse asnjë dispozitë e këtij ligji nuk e parashihet të drejtën e revizionit, dhe se *“pranimi i revizionit të të pandehurit si mjet i lejuar juridik në këtë kontest është shkelje e parimit kushtetues nga neni 31, paragrafi 1 i Kushtetutës, i cili garanton barazinë e palëve para gjykatës, dhe me këtë unë jam privuar nga e drejta e përdorimit të mjeteve juridike të lejuara siç parashihet me nenin 24, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Administrative, duke pasur parasysh se kundër vendimeve gjyqësore të marra me rastin e revizionit në procedurë kontestimore, pala nuk ka të drejtë të parashtojë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme”*.
47. Tutje parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Sipas nenit 24, paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (Ligji nr. 03/L-202), kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative, nuk lejohet revizioni, siç është parashtruar në rastin konkret, por lejohet që pala të parashtojë një kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë të gjykatës së shkallës së dytë, që në këtë rast është vendim i Divizionit Administrativ të Gjykatës së Apelit, e cila dorëzohet në Gjykatën Supreme të Kosovës. Kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, sipas nenit 25, paragrafit 1 të këtij ligji, Prokurori i Shtetit mund të parashtojë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, mirëpo me parashtrimin e revizionit nga ana e të paditurës-Ministrisë së Brendshme, si organ administrativ, i cili nuk ishte i lejuar me dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative, mua më është mohuar e drejta që t’i propozojë Prokurorit të Shtetit parashtrimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, si mjet i jashtëzakonshëm juridik sipas Ligjit për Konfliktet Administrative”*.

ii. Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës

48. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se ai ishte diskriminuar nga ana e MPB-së dhe Gjykata Supreme pasi që, siç

thekson ai, “Në rastin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm me numër P.nr.2132/2013, të datës 16.01.2017, paditësi Ahmet Hasi, zyrtar i lartë policor, e ka paditur Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës (MPBRKS) për të anuluar si të paligjshëm vendimin për degradimin nga grada e kolonelit në gradën e nënkolonelit dhe kompensimin e dëmit material. Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura MPBRKS, ankesë e cila me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, nr. 1659/2017 të datës 8.12.2020 është refuzuar si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë u konfirmua. Në lidhje me faktet e lartpërmendura, të cilat janë të padiskutueshme dhe në dispozicion të Gjykatës, rasti i parashtruesit të kërkesës është identik. Në fakt, parashtruesi i kërkesës përmes aktgjykimit të shkallës së parë të gjykatës së njëjtë në Prishtinë ka arritur që në kontest Gjykata e Apelit në Prishtinë ta konfirmojë aktgjykimin në favor të parashtruesit të kërkesës. (këto rrethana i janë paraqitur Gjykatës edhe më herët). Mirëpo, pala e paditur MPBRKS në rastin e tij ka dërguar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila me aktgjykimin e saj përfundimisht e ka zgjidhur kontestin në dëm të parashtruesit të kërkesës duke e refuzuar me vendim të prerë padinë e paditësit (në kundërshtim me vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë). Parashtruesi konsideron se me këtë rast rrezikohet drejtpërdrejt e drejta elementare e garantuar me Kushtetutë sepse Autoriteti Shtetëror në këtë rast MPBRK në rastin e A. H.nuk ka kërkuar revizion ndërsa në rastin e Bajram Koliqit ka kërkuar revizion. Shkelja e nenit 24 “Barazia para ligjit”- sipas parashtruesit të kërkesës janë aplikuar kritere dhe standarde të ndryshme si nga MPBRKS ashtu edhe nga Gjykata në Kosovë, Gjykata Supreme e Kosovës”.

49. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se në rastin e tij është shkelur parimi i barazisë para ligjit i garantuar me nenin 24 të Kushtetutës pasi që, siç thekson ai, “me rastin e vendimmarrjes nga organet administrative, që do të thotë, nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Ministrisë të Brendshme, si dhe gjatë procedurës së zhvilluar pranë gjykatave kompetente, në bazë të padisë sime kundër aktit administrativ të formës së prerë, nuk është respektuar e drejta ime që vendimet gjyqësore dhe dokumentet e tjera të më dorëzohen në gjuhën time amtare para organeve shtetërore”.

iii. Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 30 të Kushtetutës

50. Parashtruesi i kërkesës thekson se përveç të drejtave kushtetuese atij i janë bërë edhe shkelje në procedurën administrative gjatë procedimit disiplinor, ku ndër të tjera pretendon se “[...] me rastin e inicimit të procedurës disiplinore, në bazë të Njoftimit me shkrim nr. 04-1221, të datës 03.12.2012, të bërë nga Drejtori i Departamentit për Hetime të Inspektoratit Policor të Kosovës, jam njoftuar se ndaj meje ka nisur hetimi disiplinor për shkak të dyshimit se kam kryer shkelje të rëndë të obligimeve të punës nga neni 9, pika 9.1 i Udhëzimit Administrativ nr.15/2008, që ka të bëjë me mos përmbushjen dhe mos-ekzekutimin e obligimeve të caktuara që ka shkaktuar ose ka mundur të shkaktoj pasoja negative për reputacionin e policisë dhe kryerjen efikase të detyrave. Që do të thotë se ndaj meje është iniciuar procedura vetëm për një shkelje të obligimeve të përgjegjësisë. Mirëpo, përkundër faktit se procedura është iniciuar vetëm për shkak të një shkelje të obligimeve të punës, në vendimin e Drejtorit të Policisë janë përfshirë edhe disa shkelje të tjera, (Ligji për Policinë neni 34, paragrafi 3.2, Doracaku i Parimeve dhe Procedurave Parimi 3.27, pika 2, si Udhëzimi Administrativ 06/2012 për Shkeljet, Procedurat dhe Masat Disiplinore në Policinë e Kosovës neni 14 pika 1.5, (shih vendimin e Drejtorit të Policisë DPPK-01/1580/2012, të datës 27/12/2012, faqja 4) që do të thotë se mua më është pamundësuar që të mbrohen në mënyrë efektive edhe ndaj këtyre akuzave, që nga inicimi i procedurës, gjë që u theksua edhe në padinë në gjykatën për procedura

administrative". Lidhur me këtë, ai pretendon se i është shkelur neni 30 i Kushtetutës për shkak se nuk është informuar për akuzat e iniciuara ndaj tij.

51. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që: (i) të deklarojë kërkesën të bazuar (ii) të shfuqizohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 231/2021 i 20 dhjetorit 2016; (iii) Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac. nr.1663/2017 i 25 gushtit 2020 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore C. nr. 2946/2013 i 20 dhjetorit 2016, të mbeten në fuqi.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 30

[Të Drejtat e të Akuzuarit]

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

- (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;*
- (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;*
- (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;*
- (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;*
- (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;*
- (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.*

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj*
(...)

Neni 33

[Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]

- 1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me*

përrjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.

2. Dënimi i shqiptuar për një vepër penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës.

3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.

4. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përrjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

(...)

Neni 7

(Nuk ka dënim pa ligj)

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.

Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

KREU I

[DISPOZITAT E PËRGJITHSHME]

Neni 7

7.1 Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

7.2 Gjykata është e autorizuar t'i vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe t'i marr edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3, paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

7.3 Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.

MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES

[REVIZIONI]

Neni 214

214.1 Revizioni mund të paraqitet:

a) për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 188 i këtij ligji e cila është bërë në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë;

b) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale;

c) për shkak të tejkalimit të kërkesëpadisë, po që se kjo parregullsi është bërë në procedurën e zhvilluar në gjykatën e shkallës së dytë.

214.2 Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

214.3 Kundër aktgjyqimit të dhënë në procedurën e shkallës së dytë, me të cilin vërtetohet aktgjyqimi në bazë të pohimit, revizioni mund të paraqitet vetëm nga shkaqet e përmendura në paragrafin 1 pika a) dhe b) dhe paragrafin 2 të këtij neni.

214.4 Kundër aktgjyqimit të shkallës së dytë me të cilin vërtetohet aktgjyqimi i shkallës së parë, revizioni nuk lejohet për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga paragrafi 1 pika a) e këtij neni, po që se ekzistimi i tyre nuk është përmendur fare në ankesë, përveç se kur është fjala për shkeljet për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare vet gjykata e shkallës së dytë dhe ajo e revizionit.

Neni 215

Gjykata e revizionit e shqyrton aktgjyqimin e goditur vetëm në pjesën e tij të goditur me anë të revizionit dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt.

Neni 216

Palët mund të parashtrojnë me revizion fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja vetëm nëse ato kanë të bëjnë me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore të bëra në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë.

Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës

Neni 22

Hetimi disiplinor

1. Me përfundimin e hetimeve disiplinore, sipas nenit 2 paragrafit 1. nën-paragrafi 1.3 dhe 1.4 të këtij ligji, nëse IPK përcakton se është kryer një shkelje disiplinore e paraparë në Ligjin për Policinë apo aktet nënligjore për zbatim të tij, IPK i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm masën disiplinore për punonjësin e Policisë.

2. Bazuar në rekomandimin nga paragrafi 1. i këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë nxjerr vendim të detajuar me shkrim, duke e arsyetuar veprimin e ndërmarrë.

3. Pas pranimit të vendimit, punonjësi i Policisë mund të ushtrojë ankesë kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, tek Ministri, në afat prej tetë (8) ditë pune. Ministri përgjigjet në ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të saj.

4. Vendimi i Ministrit është përfundimtar në procedurën administrative. Punonjësi i Policisë mund të parashtrojë padi ndaj vendimit të Ministrit në një gjykatë kompetente.

LIGJI NR. 03/L-035 PËR POLICINË [i shfuqizuar me Ligjin LIGJI Nr. 04/L-076 për Policinë]

Neni 48

Masat për shkeljet e rënda disiplinore

Zyrtari policor ose stafi civil i Policisë i cili ka kryer shkelje të rëndë disiplinore i nënshtrohet njëres nga masat disiplinore:

- a) ndërprerjes së marrëdhënies së punës;*
- b) uljes së gradës;*
- c) largimit nga pozita komanduese;*
- d) suspendimi pa pagesë prej 30 deri në 60 ditë dhe/ose*
- e) ndalesa në pagë prej 20 deri 30 % e pagës mujore bruto deri dy muaj.*

LIGJI Nr. 04/L-076 PËR POLICINË

Neni 34

Drejtoritë Rajonale të Policisë

- 1. Në mënyrë që veprimet policore të menaxhohen me efektivitet, Policia e Republikës së Kosovës ndahet në rajone të cilat, kurdo që të jetë e mundshme, do të jenë të njëjta me kufijtë rajonal të gjyqësisë.*
- 2. Në përcaktimin e juridiksionit territorial të drejtorive rajonale, konsideratë do t'ju jepet faktorëve ashtu siç janë, mirëpo jo të kufizuar në madhësinë e rajonit, numrin e banorëve, nivelin e krimit, pozitën gjeografike, ndërtesat e rëndësishme, rrugët dhe në infrastrukturën tjetër.*
- 3. Funkcionet e Drejtorisë Rajonale përfshijnë por nuk do të kufizohen vetëm si në vijim të: 3.1. kryej detyra dhe funksione të përcaktuara me ligj, udhëzime ose urdhra të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë;*
- 3.2. përkrahë dhe mbikëqyrë efektshmërinë policore përbrenda rajonit ku shërben; dhe*
- 3.3. koordinoj detyra të ndryshme që mund të caktohen nga Drejtoria e Përgjithshme, siç janë edukimi profesional dhe trajnimi për zyrtarët policorë dhe stafin ose punët administrative lidhur me financat, objektet dhe pajisjet.*

Neni 43

Procedurat disiplinore për personelin policor

- 1. Të gjitha shkeljet disiplinore, ku përfshihet punonjësi i Policisë së Kosovës, përveç rasteve të parapara në Ligjin për Inspektoratin Policor hetohen dhe vendoset nga Policia e Kosovës.*
- 2. Shkeljet, masat dhe procedura disiplinore rregullohen me akt nënligjor.*

UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr. 06/2012 PËR SHKELJET, MASAT DHE PROCEDURA DISIPLINORE NË POLICINË E KOSOVËS [i miratuar 22 tetor 2012 dhe i ndryshuar më 14 tetor 2013]

Neni 18

Shkelja e rëndë e autorizimit

- 1. Punonjësi i Policisë së Kosovës është fajtor për shkelje të rëndë të autorizimit nëse:*
 - 1.1. Pa ndonjë arsye bindëse nuk i përmbush apo dështon në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisë të caktuara, të cilat kanë shkaktuar apo kanë mundur të shkaktojnë efekte negative në reputacionin e Policisë dhe në efikasitetin e kryerjes së detyrave;*

Neni 45

Masat për shkelje të rënda disiplinore për punonjësit e PK-së

1. Masat që mund të merren ndaj punonjësit të PK-së në rastet e shkeljeve të rënda disiplinore janë:

- 1.1. ndërprerja e marrëdhënies së punës;
- 1.2. degradim - jo më shumë se një gradë;
- 1.3. largim nga pozita komanduese apo largim në një pozitë tjetër me përgjegjësi me të ulët menaxhuese por pa e humbur gradën dhe kategorinë funksionale;
- 1.4. ndalesën në pagë mbi 20% deri në 30% e pagës mujore bruto prej dy deri në gjashtë muaj.

2. Krahas masave të përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohen edhe masat plotësuese:

- 2.1. transfer administrativ;
- 2.2. trajnim obligativ;
- 2.3. këshillim mjekësor/psikologjik dhe
- 2.4. ndalesë drejtimi të automjetit të PK-së deri në 1 vit.

Pranueshmëria e kërkesës

52. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

53. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

54. Tutje, Gjykata i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj, përkatësisht me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

55. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për parashtrimin e kërkesës, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 231/2021], të 9 qershorit 2021, pasi i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
56. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], nënregullin (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*
57. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih, rastet e Gjykatës [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26; dhe [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
58. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, Vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, Vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës

[KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNJ-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, Vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).

59. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).
60. Gjykata sjellë në vëmendje se çështja thelbësore në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet me pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e Gjykatës Supreme. Pra, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar padi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme për shkak të shqiptimit të masës disiplinore degradim në detyrë nga grada major në gradën kapiten dhe masës plotësuese transfer administrativ, me ç’rast kërkonte që të anulohet vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të detyrohej e paditura që t’ia kthej gradën major dhe ta përcaktojë në detyrat e vendit të punës Zëvendësdrejtor Regjional për hetime në Policinë e Regjionit të Pejës. Gjykata Themelore aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si dhe anuloi vendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe detyroi të paditurën që parashtruesit t’ia kthej gradën major dhe ta përcaktojë në detyrat e punës Zëvendësdrejtor Regjional për hetime në Policinë e Regjionit të Pejës. Kundër vendimit të Gjykatës Themelore, Ministria e Punëve të Brendshme paraqiti ankesë, e cila ankesë pjesërisht u refuzua sa i përket pikës II dhe III, pika IV pjesa e dispozitivit kthimi i gradës major, dhe pika V pjesa e dispozitivit sa i përket detyrimit të paditurit që paditësit t’ia kompensojë ndryshimin e pagave të papaguara për periudhën kontestuese prej 8 gushtit 2012 gjerë më 30 qershor 2016, trustin për sigurim pensional, tatimin dhe kamatën, dhe pjesërisht u aprovua ankesa lidhur me pikën IV të dispozitivit, pjesa e kërkesëpadisë që ka të bëjë vetëm me kthimin në punë si Zëvendësdrejtor Regjional për hetime në Policinë e Regjionit të Pejës, dhe pika V e dispozitivit të aktgjykimit në pjesën që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës dhe lënda për këtë pjesë iu kthye gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Ministria e Punëve të Brendshme paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, ku Gjykata Supreme e aprovoi si të bazuar revizionin dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit ashtu që refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
61. Gjykata edhe njëherë rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj ia ka shkelur të drejtat e garantuara me nenet 5, 24, 30, 31, 33 të Kushtetutës dhe nenin 6 dhe 7 të KEDNJ-së, të cilat Gjykata do t’i analizojë në pajtueshmëri me standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.
62. Ashtu siç është specifikuar edhe më lart, Gjykata rithekson se objekt i çështjes së vlerësimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, vetëm sa i përket pjesës së dispozitivit që ndërlidhet me degradimin e tij nga grada major në gradën kapiten. Ndërsa sa i përket pretendimit të tij që ndërlidhet me kthimin në vendin e tij të punës si Zëvendëskomandant për

hetime në Regjionin e Pejës, Gjykata nuk do të trajtojë këtë pjesë pasi që parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore kishte kërkuar tërheqjen e padisë, të cilën kjo e fundit e kishte aprovuar dhe për pasojë kishte konstatuar si të tërhequr padinë e tij për kthimin në vendin e punës Zëvendëskomandant për hetime në Regjionin e Pejës.

Në lidhje me të drejtën për “gjykim të drejtë” dhe mjetin juridik

Përkitazi me pretendimin për “zbatim të gabuar të ligjit”

63. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës bazohet në pretendimin e tij lidhur me caktimin e masës disiplinore të uljes së gradës nga grada major në gradën kapiten dhe masën e transferit administrativ, ku siç thekson parashtruesi i kërkesës, janë zbatuar gabimisht dispozitat e nenit 18 dhe nenit 45, paragrafi 1 pika 1.2 dhe paragrafi 2 pika 2.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2012, sepse sipas tij, *“ky udhëzim administrativ ka hyrë në fuqi më 21 tetor 2012, ndërsa masa e pretenduar disiplinore për të cilën akuzohem është kryer në një periudhë më të gjatë, përfundimisht deri më 1 qershor 2012 kur ky udhëzim ende nuk ishte nxjerrë”*.
64. Gjithashtu, në mbështetje të zbatimit të gabuar të ligjit është edhe pretendimi i parashtruesit të kërkesës se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i bazuar në legjislacion që nuk ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar disiplinore, për të cilën ai është shpallur fajtor. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se në mënyrë të gabuar është zbatuar neni 48 i Ligjit nr. 03/L035 për Policinë, i cili Ligj sipas tij nuk ka mundur të zbatohet në zgjidhjen e kësaj çështje, sepse sipas tij ky ligj ishte shfuqizuar me miratimin e Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë.
65. Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës [KI179/18](#), parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, dhe së fundmi rasti [KI76/21](#), parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34).
66. Në këtë kuptim, Gjykata në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka theksuar se edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në aspektin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik e që mund të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin përkatës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc*, Aktgjykim, paragrafi 83, *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Ruisë*, nr. 184/02, paragrafët 70-74 dhe 84; *Päduraru kundër Rumanisë*, nr. 63252/00, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], kërkesa nr. 33202/96, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih gjithashtu, rastin e cituar më lart [KI122/16](#),

parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57; rastet KI154/17 dhe 05/18, parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, paragrafët 60 deri në 65; si dhe rastin KI121/19, parashtrues *Ipko Telecommunications*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2020, paragrafi 58, dhe referencat e përdorura aty).

67. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm i njëjti i ndërlihd me faktin se në rastin e tij Gjykata Supreme ka zbatuar gabimisht dispozitat e Udhëzimit Administrativ UA 06/2012, dhe të Ligjit për Policinë, të cilat nuk ishin në fuqi në kohën kur ishte konstatuar shkelja e pretenduar disiplinore.
68. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata duhet që fillimisht të elaborojë nëse gjatë nxjerrjes së Vendimit [DPPK-01/1518/2012] të Drejtorit të Policisë, të 27 dhjetorit 2012 me të cilin ishte vendosur masa disiplinore degradim dhe transfer administrativ për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore ishte i zbatueshëm Udhëzimi Administrativ nr. 06/2012.
69. Gjykata vëren se Udhëzimi Administrativ UA 06/2012 për shkeljet, masat dhe procedurat disiplinore kishte hyrë në fuqi më 21 tetor 2012, dhe rrjedhimisht Vendimi i lartcekur i Drejtorit të Policisë, i 27 dhjetorit 2012 ishte bazuar në një akt ligjor në fuqi, përkatësisht në udhëzimin administrativ në fjalë. Rrjedhimisht, Gjykata vë në pah se aplikimi i dispozitave të kontestuara të Udhëzimit të lartcekur Administrativ ishin vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme nëpërmjet Aktgjykimit të saj të kontestuar, të nxjerrë në procedurë të revizionit me të cilin u ndryshuan aktgjykimet e instancave më të ulëta.
70. Gjykata vëren se Gjykata Supreme në rrethanat e rastit konkret, thjesht nuk është pajtuar me gjetjet e atyre gjykatave, sa i përket ligjit material të aplikueshëm, dhe ka vendosur që t'i ndryshojë vendimet e gjykatave më të ulëta, ashtu që kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ta shpallë të pabazuar, dhe vendimi i Drejtorit të Policisë të mbetet në fuqi pasi që ishte i bazuar në fakte dhe prova të konstatuara nga ana e IPK-së, ku kjo e fundit kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës si Zëvendësdrejtor Regjional për hetime në Policinë e Regjionit të Pejës, si anëtarë i disahershëm i komisionit për inspektimin e dhomës së dëshmimeve në Policinë e Kosovës në Pejë, është dashur që t'i ndërmerr të gjitha veprimet e konstatuara nga IPK-ja, e të cilat nuk i kishte ndërmarrë, me çka sipas IPK-së ka kryer shkelje të rëndë disiplinore, nga neni 18, pika (a) e Udhëzimit Administrativ nr. 06/2012, për të cilën arsye IPK i kishte rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, masat disiplinore ndaj paditësit "Degradim" dhe "Transfer administrativ". Lidhur me këtë, Gjykata Supreme konstatoi se nuk qëndrojnë konstatimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë se me vendimet kontestuese nuk konkretizohen taksativisht se cilat shkelje i ka kryer parashtruesi i kërkesës. Në këtë kontekst, Gjykata Supreme ka arsyetuar se nuk ka ekzistuar një marrëdhënie logjike juridike, ndërmjet fakteve të vërtetuara dhe ligjit material të aplikueshëm. Gjykata edhe njëherë përsërit qëndrimin e saj se një vendim i gjykatës së rregullt do të shkelte parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih rastin e Gjykatës: [KI182/21](#), parashtrues *Kamer Ukaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 qershorit 2022, paragrafi 74).
71. Është e qartë se në vendosjen e rastit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme vetëm kishte konstatuar se organet administrative në këtë rast, Drejtori i Policisë së Kosovës dhe Ministri i Punëve të Brendshme, kishin vendosur drejtë duke u referuar në gjetjet dhe rekomandimet e IPK-së.

72. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, janë shkelur si rezultat i interpretimit dhe zbatimit të gabuar të dispozitave të Udhëzimit Administrativ UA 06/2012, Ligjit për Policinë dhe Ligjit për Konflikt Administrativ nga Gjykata Supreme, kualifikohen në grupin e dytë (ii) të pretendimeve me një *“mungesë të dukshme dhe evidente të shkeljes”*.

Përkitazi me pretendimin për mohim të mjetit juridik

73. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se janë shkelur dispozitat e Ligjit për Konflikt Administrativ, përkatësisht Ligji nr. 03/L-202 i cili nuk e lejon revizionin si mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, sepse asnjë dispozitë e këtij ligji nuk e parasheh të drejtën e revizionit, dhe se *“pranimi i revizionit të të pandehurit si mjet i lejuar juridik në këtë kontest është shkelje e parimit kushtetues nga neni 31, paragrafi 1 i Kushtetutës, i cili garanton barazinë e palëve para gjykatës, dhe me këtë unë jam privuar nga e drejta e përdorimit të mjeteve juridike të lejuara siç parashihet me nenin 24, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Administrative, duke pasur parasysh se kundër vendimeve gjyqësore të marra me rastin e revizionit në procedurë kontestimore, pala nuk ka të drejtë të parashtojë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme”*.
74. Në vijim të kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ngre çështje të juridiksionit të Gjykatës Supreme për të vendosur përkitazi me kërkesën e të paditurës për revizion, pasi që sipas tij rrethanat e rastit të tij ndërlidhen me procedurë administrative dhe se revizioni si mjet juridik nuk është i lejuar. Parashtruesi i kërkesës në vijim të këtij pretendimi po ashtu thekson se si rezultat i vendimmarrjes së Gjykatës Supreme në procedurë të revizionit atij i është mohuar e drejta për mjete juridike, e garantuar me nenin 32 të Kushtetutës, pasi sipas tij ai nuk mund të parashtojë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, mjet ky i jashtëzakonshëm juridik i përcaktuar në Ligjin për Konfliktet Administrative.
75. Lidhur me këtë, Gjykata bazuar në procedurën e ndjekur para gjykatave të rregullta vëren se në rastin e parashtruesit të kërkesës procedura që nga iniciimi i saj është zhvilluar në kuadër të procedurës kontestimore dhe jo në kuadër të procedurës administrative. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës kishte dijeni për natyrën e procedurës pranë gjykatave të rregullta dhe ky fakt asnjëherë nuk është kundërshtuar nga i njëjti, deri në momentin e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar [Rev. nr. 231/2021] të 9 qershorit 2021 të Gjykatës Supreme, me të cilin u ndryshuan, në pjesë të caktuara të dispozitivit, aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët.
76. Gjykata rikujton se çdo person fizik apo juridik gëzon të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve të rregullta juridike dhe atyre të jashtëzakonshme, kundër një vendimi gjyqësor të një instance më të ulët. Bazuar në këtë rregull, Gjykata vëren se këtë të drejtë e ka shfrytëzuar e paditura Ministria e Punëve të Brendshme, duke ushtruar kërkesë për revizion, sipas nenit 211.1 të LPK-së, i cili përcakton: *“Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi”*. Megjithatë nga shkresat e lëndës Gjykata vëren se edhe parashtruesi i kërkesës në cilësinë e palës paditëse ka shfrytëzuar të drejtën e tij sipas ligjit për të dorëzuar përgjigje në revizion. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se nuk bëhet fjalë për mohimin e mjeteve juridike, siç pretendon parashtruesi i kërkesës, sepse sipas LPK-së nuk është e mundur të ushtrohet ankesë apo kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, përkatësisht mjet i jashtëzakonshëm kundër mjetit të jashtëzakonshëm.

77. Për më tepër, Gjykata rikujton se përcaktimi i natyrës së procedurës, gjegjësisht i natyrës së kontestit ngre çështje të kompetencës materiale (lëndore), e cila ekskluzivisht është domen i gjykatave të rregullta dhe jo i Gjykatës Kushtetuese. Andaj, çështja nëse në rastin konkret do të duhej zgjidhur kontesti nga marrëdhënia e punës sipas procedurës përkatëse civile apo administrative është çështje e zbatimit të ligjit nga gjykatat e rregullta.
78. Andaj, bazuar sa më sipër, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës, kualifikohet në grupin e dytë (ii) të pretendimeve me një “*mungesë të dukshme dhe evidente të shkeljes*”.

Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës

79. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka pretenduar po ashtu dhe shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, ku Gjykata vëren se në substancë, i njëjti ankohet se në rastin e tij ka pasur diskriminim, sepse “... *Autoriteti Shtetëror në këtë rast MPBRK në rastin e A. H. nuk ka kërkuar revizion ndërsa në rastin e Bajram Koliqit ka kërkuar revizion. ...janë aplikuar kritere dhe standarde të ndryshme si nga MPBRKS ashtu edhe nga ...Gjykata Supreme e Kosovës*”.
80. Megjithatë, dhe sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim, në mënyrë që një çështje të ngritet në kuadër të nenit 24 të Kushtetutës dhe atë 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së, duhet të ekzistojë dallimi në trajtim ndërmjet personave në situata të ngjashme ose të krahasueshme. (shih rastin e GJEDNJ-së, [X dhe të tjerët kundër Austrisë](#), aplikimi nr. 19010/07 Aktgjykim i 19 shkurtit 2013, paragrafi 98). Për më tepër që, jo çdo dallim në trajtim përbën shkelje të neneve të lartcekura. Në parim, dallimi në trajtim do të jetë diskriminues nëse i mungon justifikimi objektiv apo i arsyeshëm; thënë ndryshe, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim apo nëse mungon marrëdhënia e arsyeshme ndërmjet mjeteve që përdoren dhe synimit që synohet të arrihet (shih rastin e GJEDNJ-së, [Guberina kundër Kroacisë](#), aplikimi nr. 23682/13 Aktgjykim i 22 marsit 2016, paragrafi 69 dhe referencat tjera të përmendura aty). Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës përveç pretendimit për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës nuk ka arsyetuar dhe as mbështetur pretendimet e tij me prova që tregojnë se i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë.
81. Gjykata, dëshiron të rikujtojë se, si rregull i përgjithshëm, barazia para ligjit nënkupton trajtimin e barabartë të individëve që ndodhen në kushte dhe rrethana të njëjta apo të ngjashme, duke përfshirë edhe të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë me ligj. Megjithatë, barazia para ligjit nuk do të thotë që për një individ ose një kategori personash, që janë në kushte objektivisht të ndryshme, të ketë trajtim dhe zgjidhje të njëjlojta.
82. Në këtë këndvështrim, siç u theksua dhe më lart, Gjykata konsideron se është e drejtë e palës kundërshtarë se a e ushtron mjetin juridik në dispozicion, në këtë rast revizionin apo jo. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se këtu nuk bëhet fjalë për shkelje të barazisë para ligjit, apo për trajtim të pabarabartë, siç pretendon parashtruesi i kërkesës. Për më tepër, asnjë nga bazat e kërkuara sipas Kushtetutës, kur këto interpretohen në dritën e KEDNJ-së, nuk e mbështesin pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave themelore, sepse, ai në asnjë mënyrë nuk dëshmon dhe argumenton se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese nga ana e Gjykatës Supreme (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KI173/18](#), parashtrues *Nijazi Pasoma*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 32).

83. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese pasi të njëjtat kualifikohen në grupin tretë (iii) të pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”.

Përkritazi me pretendimin për mosdorëzimin e vendimeve në gjuhën e tij amtare

84. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se në rastin e tij është shkelur parimi i barazisë para ligjit i garantuar me nenin 24 të Kushtetutës duke e ndërlikuar atë me nenin 5, pasi që, siç thekson ai: “me rastin e vendimmarrjes nga organet administrative, që do të thotë, nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Ministrisë të Brendshme, si dhe gjatë procedurës së zhvilluar pranë gjykatave kompetente, në bazë të padisë sime kundër aktit administrativ të formës së prerë, nuk është respektuar e drejta ime që vendimet gjyqësore dhe dokumentet e tjera të më dorëzohen në gjuhën time amtare para organeve shtetërore”.
85. Lidhur me këtë, Gjykata nga shkresat e lëndës vëren se parashtruesi i kërkesës që në fillim të procedurës komunikimit me organet administrative e kishte bërë në dy gjuhët zyrtare, shqip dhe serbisht. Gjithashtu vërehet se në procedurën gjyqësore, nga precizimi i padisë e tutje ishte i përfaqësuar nga avokati *Mustafë Kastrati*, i cili ndër të tjera i kishte dorëzuar Gjykatës Themelore padinë në gjuhën shqipe, dhe i cili e kishte përfaqësuar parashtruesin e kërkesës deri në përfundimin e procedurës gjyqësore pranë gjykatave të rregullta.
86. Nga procesverbalet e 13 prillit 2016, 13 qershorit 2016, 24 tetorit 2016, 3 nëntorit 2016, 20 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore, përgjigjja në ankesë drejtuar Gjykatës së Apelit dhe përgjigjja në revizion, të cilat ndodhen në dosjen e lëndës, Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës ishte prezent në gjykim së bashku me avokatin e tij *Mustafë Kastrati*, dhe se gjatë gjithë procedurës gjyqësore nuk kishte ngritur asnjëherë çështjen e gjuhës dhe as mosdorëzimin e vendimeve në gjuhën e tij.
87. Gjykata, para së gjithash, rikujton se çdo pretendim i ngritur në kërkesë nga parashtruesit e kërkesave kërkon dhënien e një përgjigjeje konkrete nga ana e Gjykatës, me kushtin që kërkesa t'i përmbushë kriteret e pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Njëri ndër to është edhe ai i shterimit të mjeteve efektive juridike në procedura të rregullta pranë gjykatave të juridiksionit të rregullt.
88. Gjykata tashmë ka një praktikë të konsoliduar përkritazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin e materies/substancës (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera rastin e Gjykatës [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), më parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 gushtit 2019, paragrafët 90-96, dhe së fundmi, rastin [KI189/19](#), parashtrues *Alban Miftaraj*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 nëntorit 2019, paragrafët 49-59). Rrjedhimisht, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton detyrimin e përdorimit të mjetit juridik kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin e materies/substancës, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “substancë” para gjykatave të rregullta, në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNj. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës i kanë shfrytëzuar ato në të dyja kuptimet, në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese,

[KI71/18](#), parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; [KI119/17](#), parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafin 73; dhe rastin [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), cituar më lart, paragrafin 94).

89. Aspekti i shterimit të mjeteve juridike në substancë është i përcaktuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së dhe të Gjykatës dhe nënkupton që pretendimet për shkelje të KEDNj-së dhe të Kushtetutës duhet të jenë ngritur “të paktën në substancë” para gjykatave të rregullta në mënyrë që të njëjtave t’u jetë dhënë mundësia për të adresuar pretendimet për shkelje përkatëse (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti [KI01/19](#), parashtrues: *Fatos Rizvanolli*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 2 shtatorit 2020, paragrafët 96-100 dhe referencat e cituara në këtë rast).
90. Në këtë drejtim, GJEDNj gjithashtu përcakton që parashtruesit e kërkesave nuk mund të lirohen nga detyrimi i shterimit të mjeteve efektive juridike, edhe nëse gjykatat e rregullta mund të kenë qenë të detyruara të shqyrtojnë vet (*ex officio*) pretendimet përkatëse. Për më tepër, GJEDNj mban qëndrimin se mjeti juridik duhet të shfrytëzohet, për aq sa ekziston një mjet i tillë që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë të paktën në substancë argumentin për shkelje të një të drejte. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur pranë gjykatave të rregullta, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, kur ka mundur të ngrihet nga parashtruesi i kërkesës gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi kjo të cilën synon ta ofrojë rregulli për shterimin e mjeteve juridike (shih rastin e GJEDNj-së, [Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar 2478/15 dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar 1787/15](#), Vendim i 23 qershorit 2015, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, [KI119/17](#), cituar më lart, paragrafin 72, dhe së fundmi rastin [KI189/19](#), parashtrues *Alban Miftaraj*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 nëntorit 2019, paragrafët 49-59).
91. Në këtë kontekst, Gjykata duke iu referuar shkresave të lëndës, vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës lidhur me mosdorëzimin e vendimeve në gjuhën e tij amtare asnjëherë nuk është ngritur as si i nënkuptuar dhe as në materie (substancë), si shkelje e të drejtave kushtetuese dhe e KEDNj-së, të paktën në riprocedurë pranë gjykatave të rregullta. Prandaj, Gjykata e ka të pamundur ta trajtojë dhe analizojë tutje këtë pretendim në materie, nëse ka pasur shkelje të kësaj të drejte kushtetuese, ngase kërkesa në këtë pjesë nuk i përmbushë kriteret e pranueshmërisë, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike, në kuptim të ngritjes së shkeljes në substancë në gjykatat e rregullta (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës [KI68/21](#), parashtrues *Leonard Matoshi*, Aktvendimi i 3 nëntorit 2021, paragrafët 58-66).
92. Gjykata dëshiron të rikujtojë gjithashtu se, përjashtimi nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike vjen në shprehje vetëm atëherë kur Gjykata bindet se shfrytëzimi i mjetit juridik përkatës mund të mos jetë efektiv në dhënien e një përgjigjeje të arsyetuar, një pretendim të ngritur nga parashtruesit e kërkesave në gjykatat e rregullta. Në rastin konkret, pretendimi i parashtruesit të kërkesës bie në fushëveprimin e nenit 24 të Kushtetutës, andaj, duke pasur parasysh parimet kushtetuese të përcaktuara me nenet 53 dhe 102.3 të Kushtetutës, Gjykata konsideron se kjo mundësi duhet shfrytëzuar nga parashtruesit e kërkesës.
93. Andaj, duke i marrë parasysh këto shtjellime, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë Gjykatës Supreme të adresojnë këtë pretendim dhe të korrigjojnë shkeljen e pretenduar, lidhur me mosdorëzimin e vendimeve në gjuhën e tij amtare. Rrjedhimisht, kërkesa në këtë pjesë deklarohet e papranueshme

në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (b) të Rregullores së punës.

Përkitazi me pretendimet për shkelje të neneve 30 dhe 33 të Kushtetutës

94. Gjykata rikujton se përveç pretendimeve për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe barazisë para ligjit, parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu në shkelje të së drejtës së garantuar me nenet 30 dhe 33 të Kushtetutës, për shkak se nuk është informuar për akuzat e ngritura ndaj tij dhe se i është pamundësuar që të mbrohen në mënyrë efektive edhe ndaj këtyre akuzave.
95. Gjykata, para së gjithash, rikujton se parashtruesi i kërkesës në rastin konkret ankohet lidhur me procedurën disiplinore të ndërmarrë ndaj tij, përkatësisht lidhur me degradimin e tij, dhe se këtu kemi të bëjmë me procedurë kontestimore dhe jo me procedurë penale. Lidhur me këtë, Gjykata konstaton se neni 30 dhe 33 i Kushtetutës nuk janë të zbatueshëm në rastin e parashtruesit të kërkesës, dhe se Gjykata nuk do të merret me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të këtyre neneve.

Përfundim

96. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se:
- i. pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, në ndërlidhje me aplikimin e gabuar të ligjit material, i takojnë kategorisë së e dytë (ii) të pretendimeve me një "*mungesë të dukshme dhe evidente të shkeljes*", andaj në baza kushtetuese të njëjtat duhet shpallur qartazi të pabazuara;
 - ii. pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i takojnë kategorisë së e dytë (ii) të pretendimeve me një "*mungesë të dukshme dhe evidente të shkeljes*", andaj në baza kushtetuese të njëjtat duhet shpallur qartazi të pabazuara;
 - iii. pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] në ndërlidhje me (i) diskriminimin, i takojnë kategorisë së tretë (iii), të pretendimeve "*të pambështetura ose të paarsyetuara*", andaj në baza kushtetuese edhe këto pretendime i shpallë qartazi të pabazuara;
 - iv. pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 në lidhje me nenin 5 të Kushtetutës, i shpallë të papranueshme për shkak të mosshërimit të mjeteve juridike, në pajtim me nenin 47. 2 të Ligjit, dhe rregullin 34 (1) (b) të Rregullores së punës.
 - v. pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 30 dhe 33 të Kushtetutës, i shpallë po ashtu qartazi të pabazuara, sepse të njëjtat ngrenë çështje të natyrës penale, dhe nuk aplikohen në rastet e natyrës civile kontestimore sikurse ka ndodhur në rastin konkret.
97. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, në pajtueshmëri me rregullin 34 (1) (b) dhe 34 (2) të Rregullores së punës, duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 34 (1) (b) dhe (2), si dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur, më 27 korrik 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani